



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 67, nenin 68, nenin 69 nenin 70 nenin 71 nenin 72 dhe nenin 73 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 5 paragrafi I të Rregullores Zgjedhore Nr.02/2024 Emërimi, Përbërja dhe Funksonimi i Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve, nenin 41 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese me datën 13.09.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarëve të Komisionit Komunal të Zgjedhjeve

- I. Emërohen Anëtarët e Komisionit Komunal të Zgjedhjeve, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025.
- II. Regjistri i anëtarëve të Komisioneve Komunale të Zgjedhjeve për komunat, si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Mandati i KKZ-ve, do të fillojë nga data e emërimit sipas këtij vendimi dhe do të përfundojë pesëmbëdhjetë (15) ditë pas certifikimit të rezultatit të zgjedhjeve, përveç nëse mandati i KKZ-së ndërpritet para përfundimit të afatit ose zgjatet me vendim të KQZ-së.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.09.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radonij




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me nenin 63, nenin 64.2 Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 6 paragrafi 1 dhe neni 7 paragrafi të Udhëzimit Administrativ (MAP) Nr.01/2017 për Administrimin e Punës në Zyrë, Evidencat Themelore dhe Detyrat e Punës së Arkivistit, Rregulloren (MAP) Nr. 01/2015 Për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve, dhe afatet e ruajtjes së tyre, si dhe Rregulloren (MPB) Nr.05/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (MAP) Nr.01/2015 Për Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve dhe afatet e ruajtjes së tyre, nenin 41 të Ligjit Nr.05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përmes votimit në procedurë qarkulluese më datë 13.09.2024, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Shenjave Unike të Klasifikimit të Dokumenteve Zyrtare Sipas Strukturës Organizative në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

- I. Miratohen “Shenjat Unike të Klasifikimit të Dokumenteve Zyrtare Sipas Strukturës Organizative në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve”.
- II. Shenjat unike të dokumenteve zyrtare si në pikën I, janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- III. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet vendimi i datës 27.09.2022 Nr.1104/2022, për miratimin e Shenjave Unike të Klasifikimit të Dokumenteve Zyrtare në KQZ.
- IV. Obligohet Sekretariati për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 13.09.2024

Kryesues

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve


Kreshnik Radoniq

